

VENDIM
Nr. 674, datë 29.7.2015

**PËR KALIMIN E SPORTELEVE PRITËSE PËR QYTETARËT TË ZYRAVE
VENDORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME NË
ADMINISTRIM TË QENDRËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë dhe ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sportelet pritëse për qytetarët (*front-office/FO*) të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme kalojnë në administrimin e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA).

2. Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministri i Drejtësisë, me urdhër të përbashkët, përcaktojnë sportelet e shërbimit që do të kalojnë nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në administrimin e Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.

3. Mënyra e shkëmbimit të informacionit midis sporteleve pritëse për qytetarët (FO) të zyrave mbështetëse përgjegjëse për përpunimin e të dhënave dhe finalizimin e shërbimeve publike (*back-office/BO*) si organ kompetent do të rregullohet me një marrëveshje të përbashkët ndërmjet ZQRPP-së dhe Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara. Në këtë marrëveshje do të përcaktohen procedurat e kalimit të shërbimeve e të dokumentacionit, sigurisë, menaxhimit të aseteve të përbashkëta, si dhe çështje të tjera në bazë dhe për zbatim të këtij vendimi.

4. ZQRPP-ja dhe Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, nëpërmjet Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), të kryejnë trajnimin e punonjësve për kuadrin ligjor të pasurive të paluajtshme.

5. Efektet financiare të mbulohen nga buxheti i ADISA-s.

6. Tarifat dhe taksat, që do të mbliidhen nga Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara, të jenë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të kalojnë në llogarinë e ZVRPP-së.

7. Çështjet, që kanë të bëjnë me administrimin/pronësinë e aseteve që janë në përdorim të sporteleve pritëse për qytetarët në ZVRPP, të rregullohen me marrëveshje të përbashkët ndërmjet ZQRPP-së dhe Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara.

8. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Ministria e Financave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama